



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-125

Prishtinë, më 16 shtator 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 16 SHTATOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendi; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavljeviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinković.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga: OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve së Kryesisë, të mbajtura më 5 dhe 11 shtator 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 5 dhe 11 shtator 2013

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 5 dhe 11 shtator 2013.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

A) Vazhdimi i seancës plenare

Për vazhdimin e seancës plenare, përkatësisht për procedimin e raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së, diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, nënkryetarët e Kuvendit: Xhavit Hali dhe Sabri Hamiti, dhe kryetarët e grupeve parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Myzejene Selmani, diskutimet të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, me shumicë votash: me tetë (8) vota për (Xhavit Haliti, Petar Miletqi, Rasim Demiri, Adem Grabovci, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinkoviq) dhe me gjashtë (6) vota kundër (Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Ismet Beqiri, Visar Ymeri dhe Ardian Gjini), vendosi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet më 19 shtator 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së,*
2. *Formimi i Komisionit ad hoc për shqyrtimin e aplikacioneve lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe*
3. *Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.*

B) Caktimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare të mbahet të enjten, më 19 shtator 2013, në orën 12:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja,*
- 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike,*
- 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102,*
- 7. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012,*
- 8. Zgjedhja e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.*

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

- 1. Procedimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin Mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronës*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, si Komision FunkSIONAL, që ta shqyrtojë propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

- 2. Rekomandimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës*

Për rekomandimin e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit; Visar Ymeri, kryetar i GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini, kryetar i GP të AAK-së; diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia lidhur me rekomandimin e lartshënuar nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga komisionet parlamentare që, me rastin e shqyrtimit të çështjeve nga fushëveprimi i tyre, të konsultohen me zyrtarët përgjegjës të Drejtorisë së Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që të kërkojë nga Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës që deri më 31 dhjetor 2013 t'i lirojë hapësirat (zyrat) e ndërtesës së Kuvendit.

3. Njoftimi i anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media, Emrush Kastrati, për dhënien e dorëheqjes

Kryesia u informua lidhur me dorëheqjen e z. Emrush Kastrati nga pozita e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kroaci

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i nënkryetarëve të Kuvendit: Xhavit Haliti dhe Petar Miletqi, si dhe Ariana Musliu nga stafi mbështetës i Administratës së Kuvendit, për të marrë pjesë në sesionin vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili do të mbahet në Kroaci, prej 10-15 tetor 2013.

2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Pika shtesë:

1. Kërkesa për miratimin e shpenzimeve të organizimit të Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet mbulimi i shpenzimeve me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë, në shumën deri në 10 000 (dhjetëmijë) euro, sipas faturave të bashkëngjitura.

Të ndryshme:

Kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, shtroi çështjen e vazhdimit të afatit të pasaportave diplomatike për deputetët e Kuvendit.

Kryetari konstatoi me çështjen e pasaportave diplomatike për deputetët e Kuvendit duhet të merret Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërparlamentare e Administratës së Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*